

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                 |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | SPAK: Masë arresti për kreun e SHISH, Vlora Hyseni dhe dy të tjerë, kontrolle për Prodën - REPORT.AL                                                                                                                            |
| ADRESA  | <a href="https://report.al/spak-mase-arresti-per-kreun-e-shish-vlora-hyseni-dhe-dy-te-tjere-kontrolle-per-proden/">https://report.al/spak-mase-arresti-per-kreun-e-shish-vlora-hyseni-dhe-dy-te-tjere-kontrolle-per-proden/</a> |
| BURIMI  | report.al                                                                                                                                                                                                                       |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                          |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 23 shtator 2026, 05:09:46 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 22 shtator 2026, 13:13:19 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 16fa34755fd828d9c3ed7c5de1e3e37f615289a07a557b95aa79a501abb2d502 |
| TEKSTI     | b7ac8e70806a41aabddd68a4c3bbe3aa103fc3e690a748a12b3f83e7b418135e |
| PAMJA      | c95d248df3ba1a66007a4e96ff779e7f1e43164f5e242e6e854b373a27149d8e |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 49cf207717db85d7eb145dab60fa2165e60eac831ffc4df540a32f141ed28827                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/49cf207717db85d7eb145dab60fa2165e60eac831ffc4df540a32f141ed28827>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Home Aktualitet

# SPAK: Masë arresti për kreun e SHISH, Vlora Hyseni dhe dy të tjerë, kontrolle për Prodën

by Lajm Lajm — September 22, 2026 in Aktualitet, Kryesore

0  
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka zbardhur detajet e operacionit të zhvilluar paraditen e kësaj të marte, 22 shtator, në kuadër të hetimeve për dosjen e AKSHI-t.

Sipas njoftimit zyrtar, Gjykata e Posaçme ka caktuar tre masa sigurie ndaj personave nën hetim, ndërsa janë autorizuar edhe kontrolle në disa ambiente.

Ndaj **Vlora Hysenit**, me detyrë Drejtor i Shërbimit Informativ Shtetëror, është caktuar masa e sigurisë “arrest në shtëpi”, së bashku me pezullimin e ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik. Ajo po hetohet për veprat penale të parashikuara nga nenet 320/2 dhe 295/a/1 të Kodit Penal.

“Arrest në burg” është caktuar për Fatjon Kallucin, Përgjegjës Sektori në Institutin e Policisë Shkencore, i dyshuar për veprën penale të parashikuar nga neni 295/a/1 i Kodit Penal.

Në burg është urdhëruar edhe Embro Sulejmani, punonjës i shoqërisë “Agroturizëm Kodra e Kuajve”, i dyshuar për veprën penale të parashikuar nga neni 302/2 i Kodit Penal.

Sipas SPAK, vendimet për masat e sigurisë i janë përcjellë Policisë së Shtetit, e cila ka ekzekutuar dy prej tyre, duke arrestuar Kallucin dhe Sulejmanin, ndërsa Vlora Hyseni ndodhet jashtë vendit.

Po ashtu, në kuadër të të njëjtit hetim, është autorizuar edhe kontrolli i banesës dhe kontrolli personal i Ilir Prodës, ish-funksionar i lartë i Policisë së Shtetit.

Gjithashtu, në shënjestër janë vënë edhe dy komplekse vilash në zonën e Shkozetit në Durrës, në kryqëzimin e rrugës “Durrësi në Shekuj” me rrugën “Bajram Tusha”, ku janë ushtruar kontrolle nga BKH.

Akuzat ndaj tyre dhe lidhja me dosjen e AKSHI-t

Operacioni i zhvilluar këtë të martë është raportuar si vijim i hetimeve të SPAK për të ashtuquajturën dosja e AKSHI-t, ku në qendër të hetimeve është edhe biznesmeni Ergys Agasi.

Sipas raportimeve, nga materialet e sekuestruara dhe të administruara gjatë hetimit ndaj Agasit, prokurorët kanë identifikuar komunikime dhe të dhëna që kanë çuar hetimin drejt personave të tjerë, mes tyre

## TË FUNDIT

Tifozi i Manchester United është bërë i famshëm, Haaland i bën komentin epik: Priti flokët, shoku!

SEPTEMBER 22, 2026

Si po i shpëton hetimit të SPAK Adrian Bardhi i “Pascucci”; ortaku i Ergys Agasit te “Dinamo” dhe pjesë e grupit të tij kriminal

SEPTEMBER 22, 2026

Nis beteja në Apel për katër ish-krerët e UÇK-së

SEPTEMBER 22, 2026

Presidenti i Federatës Gjermane sulmon Infantinon: Një manovër e qartë për të qëndruar në pushtet

SEPTEMBER 22, 2026

BE zgjat sanksionet ndaj Rusisë me 3 vjet

SEPTEMBER 22, 2026

“Nesër më shumë!” - Përfundon protesta e 115-të antiqeveritare, qytetarët të vendosur në qëllimin e tyre: Edi Rama, dorëhiq!

SEPTEMBER 22, 2026

“Zbatim më i fortë i ligjit”- Mesazhi i ambasadës amerikane: Kur SHBA dhe Shqipëria qëndrojnë së bashku, komunitetet tona janë më të sigurta

SEPTEMBER 22, 2026

Protesta/ Arben Kola: Vlora Hyseni, na e fëlliqe emrin e qytetit! E ke kthyer SHISH-in në fole të UDB-së!

SEPTEMBER 22, 2026

Presidenti Begaj dekreton shkarkimin e Vlora Hysenit nga drejtimi i SHISH

SEPTEMBER 22, 2026

Aksident në Lezhë, vdes 50-vjeçari

SEPTEMBER 22, 2026

drejtuesja e SHISH, një zyrtar i Policisë Shkencore dhe administratori i një agroturizmi në Durrës.

**Vlora Hyseni** është personi me funksionin më të lartë ndaj të cilit është marrë masë në këtë fazë të hetimit. Sipas akuzave të bëra publike nga SPAK, ajo hetohet për *"përkrahje të autorit të krimit"* dhe *"zbulim të akteve ose të dhënave sekrete"*. Ka dyshime se Hyseni i ka përcjellë informacione shtetërore Ergys Agasit dhe se ka favorizuar biznesmenin gjatë kohës që ai ishte në arrati.

Në të njëjtin hetim është arrestuar edhe **Fatjon Kalluçi**, shef në Laboratorin Shkencor të Policisë. Kalluçi është përfshirë në fraksionin e ri të hetimit të dosjes së AKSHI-t, ndërsa akuzohet për *"Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete"* te grupet kriminale.

Ndërsa **Embro Sulejmani**, administrator i agroturizmit **"Kodra e Kuajve"** në Durrës, akuzohet për përkrahjen e autorit të krimit, pasi ka dyshime se i ka dhënë ndihmë Ergys Agasit gjatë periudhës kur biznesmeni ishte në kërkim.

Raportimet pretendojnë se Agasi ka zhvilluar takime në ambientet e agroturizmit dhe se pamjet e kamerave të sigurisë janë fshirë, çka po verifikohet nga hetuesit si pjesë e dyshimeve për ndihmë ndaj tij.

Ndërkohë, sa i takon ish-drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Ilir Proda, ai ka dalë në materialet e hetimit ndaj Agasit dhe po verifikohet nëse gjatë kohës që drejtonte Policinë e Shtetit ka shkëmbyer informacione me biznesmenin. Për këtë arsye, SPAK ka ushtruar kontroll në banesën e tij dhe ka sekuestruar pajisje elektronike për t'i administruar si prova në hetim.

Vetë Ergys Agasi është vënë në pranga në kuadër të këtij hetimi për dosjen AKSHI dhe dyshohet për një sërë veprash penale, mes tyre konkurrencë të paligjshme nëpërmjet dhunës, heqje të paligjshme të lirisë, shkelje të barazisë së pjesëmarrësve në tendera në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, grup të strukturuar kriminal, pastrim të produkteve të veprës penale dhe korrupsion aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike.

Hetimet vijojnë për të zbardhur rolin e secilit prej personave në dosje si dhe lidhjet mes tyre.

Tags: AKSHI hetime operacion spak

Previous Post

"Bleona Mata në Greqi"/ Avokati i familjes hedh poshtë pretendimet, sqaron të vërtetën

Next Post

Arresti për Vlora Hysenin çorodit Rilindjen/ Fatmir Xhafaj: "Ndodh edhe në SHBA", Bledi Çuçi: "Ndihehem krenar"



Lajm Lajm

report.al


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencia dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet  
OP-ED  
Politike  
Rajon  
Showbiz  
Sociale  
Shëndet  
Sport

MË TË KLIKUARAT



E rëndë në Dibër, 22-vjeçarja mbytet në lumin Drini i Zi

0 SHARES

01



Është studente ekselente, e birësuar nga një çift grek/ Trondit avokati: Bleona Mata është gjallë

0 SHARES



Falsifikime dhe shpërdorim detyre, pezullohen 2 zyrtarë në Tiranë

0 SHARES

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.